



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1463 / Prot. 2

Vlorë më, 21.5.2025

VENDIM

Nr. 60, datë 21.05.2025

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PROCESIT TË VETËKANDIDIMIT PËR
ANËTARË TË KËSHILLIT TË ETIKËS NË UV**

Në mbështetje të nenit 44, të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 28, pika 2 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, referuar Vendimit Nr. 51, datë 29.04.2025 të Senatit Akademik, në të cilin, pas shpalljes publike të procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Këshillit të Etikës në UV, nuk u plotësua numri i kandidaturave, Senati Akademik në mbledhjen e tij të radhës datë 21.05.2025

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit për procesin e vetëkandidimit për anëtarë të Këshillit të Etikës me qëllim plotësimin e këtij pozicioni dhe mbarëvajtjen e punëve në Institucion deri në datën **06.06.2025**.
2. Vendimi t'i njoftohet gjithë personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ, Këshillit të Etikës aktual dhe Këshillit studentor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

